



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI I KOMUNËS **KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA**

EKSTRAKT

nga Procesverbali i mbajtur më 28 tetor 2019, në mbledhjen e XVII-të (shtatëmbëdhjetë), mandati VI, të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mbledhja u mbajt në sallën nr.31 dhe filloi në orën 13:40.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, përkatësisht kryesues i këtij Komiteti.

Fillimisht u konstatua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti: Mehmet Gashi, Arlinda Kadriu, Avni Fetahu, Fatlume Jaha, Adelinë Stublla, Rafet Llapashtica, përveç Floretë Zejnullahu dhe Fitim Haziri të cilët munguan.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje të pranishëm ishin; Isuf Latifi, Drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave – DBF, Faik Muçiqi, Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit – DSHPMSh, Gëzim Namani Drejtor i Drejtorisë së Administratës – DA, Durim Salihu, Drejtor i Inspeksionit - DI, Mirsad Kamerrolli, Drejtor i Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik – DPZHE dhe Driton Nuli – OSBE.

Rendi i ditës

z.Fatmir Gashi, Kryesues, e hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit dhe njoftuar rreth pikave të paraqitura në këtë rend të ditës, shtoi, thirrjen materialin përkatës për këtë mbledhje e keni marrë të gjithë me kohë, andaj mund të vazhdojmë me punë.

Njëzëri u miratua rendi i propozuar i ditës sipas thirrjes dhe materialit përkatës të dërguar

1. Ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtur më 20 shtator 2019

Njëzëri miratohet pa vërejtje, plotësim ndryshime.

2. Draft Strategjia për Zhvillimin e Turizmit 2019 – 2021 në Komunën e Podujevës

z.Mirasd Kamerolli, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik-DPZHE, theksoi, ne e kemi paraqitur këtë Draft Strategji për Zhvillimin e Turizmit me të cilën kemi paraparë një analizë të përgjithshme të resurseve turistike që i ofron Komuna e Podujevës, fatkeqësisht deri tash nuk e kemi pasur një përshkrim, nuk themi që është e përkryera, ka mundësi të bëhet edhe më mirë por kaq janë kapacitetet e operatorit ekonomik dhe kapacitetet tona të brendshme e që ka mungesë të njohurive në këtë fushë. Në fakt sa i përket këtij dokumenti në nivel Kosove jemi Komuna e dytë së bashku me Komunën e Pejës e cila poashtu është në fazën e përpilimit pas Prizrenit. Unë po besoj që është një dokument i cili në të ardhmen do t'i hyj në punë Komunës që ti japim kahje zhvillimit të turizmit dhe të paraqitet si dokument para donatorëve të mundshëm që mund të jenë mbështetës të ardhshëm në turizmin e Komunës, qoftë të turizmit malor, shëndetësorë ose formave tjera të produkteve turistike që mundemi me i pas dhe me i identifikuar në nivel Kosovës ato produkte turistike përkatëse. Pres që të kemi mbështetje nga ana e gjitha Grupeve të Kuvendit. Operatori ka bërë një komunikim të gjithanshëm me të gjithë akterët që janë në rrjedha të përgjithshme të jetës sonë brenda territorit të Komunës së Podujevës, qoftë shoqatën e historianëve, gjeografëve, profesor dhe njohës të fushave të ndryshme në mënyrë të vazhdueshme të cilët kanë tentuar dhe kanë mbledh informacione të rëndësishme për këtë fushë, pastaj ne si Komunë dhe si Drejtori, kemi qenë gjithnjë në bashkëpunim me operatorin përkatës në mënyrë që ti ofrojmë me secilën mundësi që kemi pasur dhe kapacitetet tona që të bëjmë më të mirën e mundeshe lidhur me këtë strategji.

z.Avni Fetahu, theksoi, Grupi i këshilltarëve nga radhët e LDK-së e mbështet dhe i rekomandon për Kuvend këtë dokument, mirëpo për kureshtje nëse Komuna është bashkë financuese, a është mbajtur ndonjë diskutim publik, nëse nuk është mbajtur konsideroj se do të duhej të vihet në diskutim publik për të jap rekomandimet sepse shihet qartë që ka vend për rekomandime. Nëse është bashkë financuese Komuna nuk e di a ka kaluar ndonjë Strategji e Zhvillimit pa u diskutur.

z.Mirasd Kamerolli, drejtor i DPZHE, përgjigje parafolësit, ky është drafti fillestar, ne në seancë të Kuvendit mund t'i marrim rekomandimet e juaja dhe në seancën e nëntorit pastaj ta sjellim sërish për miratim pas ndryshimeve që mund të pësoj ky draft. Megjithatë unë e ceka edhe në fjalën hyrëse, operatori ekonomik edhe unë si drejtor kam marrë pjesë të paktën në gjashtë takime nëpër komunitete të lokaliteteve të ndryshme të territorit të Komunës së Podujevës (Orllan, Majac, Sllatinë etj) dhe nuk e besoj që është miratuar ndonjë dokument deri tani me diskutim më të gjerë nëpër vendbanime të ndryshme sikur kjo Strategji. I keni në dokument të gjitha pikat dhe mund t'juja sjell të gjitha procesverbalet kush ka marr pjesë dhe kush ka jap rekomandime lidhur me pikat e caktuara turistike të cilat kanë operuar në atë pjesë të vendit ose e kanë ndonjë vlerë më të veçantë qoftë tek vlerat turistike apo historike dhe cila do që të jetë. Ne jua sjellim në seancë si material shtesë të gjitha procesverbalet nga takimet publike.

z.Adelina Stublla, theksoi, edhe ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e LVV-së e mbështesim si pikë që e njëjta të rekomandohet për seancën e Kuvendit.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, edhe unë në emër të grupit të këshilltarëve të PDK-së e mbështes që si pikë e rendit të ditës të rekomandohet për seancën e Kuvendit. Sa e kuptova unë, kjo do të sjellët në Kuvend për miratim por nëse donë me ardh në formën finale dhe me u votua duhet të sillet si Strategji e jo si draft, në bazë të rregulloreve dhe procedurave administrative kjo duhet me qenë në fazën finale për miratim por nëse sjellët si draft proceduralisht duhet të caktohet një datë e diskutimit publik dhe pastaj të plotësohet, nëse e keni për ngutë për ta kompletuar dokumentin, atëherë në Kuvend sjellët për miratim si strategji finale dhe eventualisht nëse dikush si arsyeshmëri ka diçka në seancë mundet të plotësohet por nëse jo shtypet strategjia dhe kjo mbetet si dokument për tu prezantuar para vizitorëve të ndryshëm.

z.Mirasd Kamerolli, drejtor i DPZHE, theksoi, sa i përket konsultimit publik, besoj që i kemi përfundua gjerë e gjatë me të gjithë akterët, mirëpo ne mund të caktojmë një datë dhe e mbajmë debatin publik, por sa unë jam në dijeni diskutimet janë mbajtur në tërë territorin e Komunës për rreth 40 ditë edhe kemi procesverbalet ku janë mbajtur për secilin takim.

z.Fatmir Gashi, Kryesues, theksoi, ne e kemi materialin para vetes dhe propozimi është që kjo Draft Strategji për Turizmin të shkojë në Kuvend dhe i propozohet për miratim nëse i plotëson kushtet dhe kriteret duhet të vihet për miratim, nëse nuk i plotëson kushtet dhe kriteret të thuhet këtu sepse nuk mund t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim me dy opsione.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, i nderuar drejtor, ti e ke sjell si draft ndërsa Kryetari si strategji, në propozim thuhet miratimi i strategjisë jo i draftit, tani proceduralisht po ta shikojmë është dashtë të del në diskutim publik, ti i ke mbajtur takimet me qytetar por zyrtarisht nuk ke caktuar debat publik dhe ne si Kuvend nuk e kemi dhënë një miratim të tillë për këtë dokument.

z.Mirasd Kamerolli, drejtor i DPZHE, theksoi, nëse është bërë gabim teknik kërkoj falje i nderuar Kryesues, ne konsiderojmë se është mirë t'i rekomandojmë Kuvendit si Draft për diskutim nesër për hir të obligimeve ligjore që i jep ligji në raport me miratimin e dokumenteve zyrtare.

z.Fatmir Gashi, Kryesues, theksoi, këtu s'kemi të bëjmë me gabim teknik fare, propozimi është që Draft Strategjia të rekomandohet për shqyrtim dhe miratim në Kuvend, nëse i plotëson kushtet dhe kriteret, nëse jo duhet të përcaktohem si çka ta dërgojmë.

z.Mehmet Gashi, theksoi, këto çështje që u diskutuan, zyra ligjore i din më së miri si është me ligj le të dërgohet. Unë e përkrahi këtë material sepse është shumë i dobishëm. Gjatë leximit të materialit i kam vërejtur disa pika shembull tek faqe 10 ku thuhet se në përgjithësi Komuna e Podujevës ka pozitë të mirë gjeografike sepse në të kalojnë rrugë tranzitore, autorrugë dhe hekurudha. Tek hekurudha ajo që 20 vite nuk funksionon nuk e di a ka nevojë me jap aty një sqarim që nuk është funksionale për momentin, tjetra është ku thuhet lidhet në veri-lindje përmes qafës së Përpellacit me Republikën e Serbisë, qafa e Përpellacit ka qenë para viteve të 70-ta tani nuk e di si quhet por besoj që është përmes Merdarit.

Pastaj dhe tjetra ku thuhet, në përfundim shtrihet tek malet e Bajgorës maja e mprehtë e ashtuquajtur Ostrokopje, ne me kolegun z.Avni Fetahu para një jave kemi qenë atje dhe kemi shikuar në google ku thuhet se është lartësia më e lartë në këto anë 1789m këtu ka dalë është 1879m, edhe njëherë të shikohet dhe verifikohet cila është e saktë, e që mendoj që kjo në material nuk është mirë por e sakta është 1789m, është mirë që kur të miratohet ky material të jetë sa më i saktë, të gjitha këto janë në faqen 10, përndryshe e përkrahi këtë material që të kalojë.

z.Mirasd Kamerolli, drejtor i DPZHE, theksoi, për secilin takim ne i kemi procesverbalet kush ka debatuar, kush ka jap propozim. Nëse është detyrim ligjor ne shkojmë siç e parasheh ligji.

z.Durim Salihu, drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit, theksoi, rendi i ditës ka ardhur si Draft Strategji, drafti është diçka tjetër strategjia finale është diçka tjetër. Draft strategji për tu miratuar në Kuvend s'ka logjik tani nëse hiqet shprehja draft dhe të mbetet vetëm Strategji e turizmit, ngase është diçka tjetër.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, termi draft të hiqet, përndryshe fazën finale e ki, proceset e takimeve i ke, ndonjë vërejtje teknike e rregullon që është dhe në propozim kur të dalësh në Kuvend, cilësojeni vetës miratim i strategjisë dhe përmbyllet kjo çështje.

z.Avni Fetahu, theksoi, të jemi të qartë, Strategjia është shumë e mirëseardhur dhe është dashtë të vijë edhe më herët, por ta qartësojmë që krejt është në rregull ka mund të diskutohet me të gjithë akterët e mundshëm por dihet që faktorët kryesor janë ata që janë në Kuvend dhe mos me pas diskutim publik në Kuvend mua po më duket e pa arsyeshme dhe po flas në emër personal. Unë këtë draft kur e kam marrë kam menduar që do të diskutojmë në Kuvend për të që me u pasurua më shumë ky dokument, këto propozime aty për aty nuk e pasurojnë Strategjinë, por është dashtë me u sjell me propozim për diskutim publik me një datë të caktuar, me i jap rekomandimet pastaj me u sjell për miratim.

Ju po e shihni që ka edhe vërejtje teknike që mundën me dal edhe banalizuese që mos me i ditë edhe ato pikat më të larta prej një kompanie që unë e kam konsideruar gogja të mirë dhe që kanë jap kontribut edhe më herët, por nuk mund të votojmë për diçka kur ne e dimë se si janë mundësit dhe potencialet që i kanë këto anë, prandaj më e udhës është që të sjellët për diskutim të jepen ide dhe pastaj të miratohet.

z.Mirasd Kamerolli, drejtor i DPZHE, theksoi, atëherë e dërgojmë si Draft Strategji në diskutim me datën 15 nëntor në diskutimi publik me të gjithë ata që janë të interesuar ndërsa draftin final e sjellim në seancën tjetër. Unë jam duke e marrë për bazë atë që thashë se mungesa e njerëzve ekspert të kësaj fushe brenda Komunës, e që të jeni të bindur se edhe brenda Qeverisë së Kosovës dhe Departamentit të Turizmit në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë kemi qenë dhe jemi takuar dhe në aspektin e ekspertëve janë edhe më keqe. Unë kam dashur ta bëjë një hapë të parë për të hapur dritaren e turizmit në Komunën e Podujevës, dhe ky është hapi i parë, tani vazhdojmë edhe në të gjitha sektorët e fushës së turizmit, pastaj mundemi të operojmë edhe në fusha të caktuara në kuadër të turizmit. Prandaj në këtë seancë mund të shkojmë me këtë variant.

z.Fatlume Jaha, theksoi, edhe unë i bashkohem kolegëve që thanë se është e mirëseardhur kjo strategji, meqë mbet me u sjellë në diskutim unë do kërkoja ndoshta edhe nga kompania hartuese që kjo strategji ti nënshtrohet edhe lekturimit nëse nuk i është bërë, shembull sidomos tek pjesa e fshatrave meqenëse është dokument zyrtar do të ishte mirë që të gjithë fshatrat që janë aty të jenë të shkruara drejtë, e them këtë ngase rastësisht e pash që fshati Sfeçël është shkruar me Sveqla, pastaj janë disa fshatra të cilat janë shkruar me gabime, pa ë-ja ose diçka tjetër, ndoshta është shumë teknike por meqenëse është dokument zyrtar dhe del nga Komuna do të ishte mirë që emrat e fshatrave të jenë siç duhet.

z.Avni Fetahu, theksoi, edhe një propozim, kur është hartuar Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal, përveç gjuhës angleze është bërë një kopje edhe në gjuhën gjermane ngase si Komunë vazhdimisht kemi një komunikim të mirë edhe me Gjermaninë, a është menduar të bëhet kjo strategji edhe në gjuhë tjetër përveç në shqip sepse kur vijnë investitorët nuk kemi si t'jua prezantojmë atyre pastaj, e që kjo as në gjuhën angleze nuk është sa jam në dijeni.

z.Mirasd Kamerolli, drejtor i DPZHE, theksoi, ne e kemi menduar që hapin e dytë të përgatitim disa broshura e që do të jenë në tri gjuhë, shqip, anglisht dhe gjermanisht. Ky si dokument është gogja voluminoz dhe nuk e kemi paraparë, megjithatë tash kushtet e tenderimit janë mbyll dhe nuk mundemi t'i japin punë shtesë operatorit diçka që nuk është paraparë me kohë.

Njëzëri i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim, me rekomandim që dokumenti i Draft Strategjisë për zhvillimin e Turizmit 2019-2021 të vihet në diskutim / debat publik, dhe atë, Diskutimi Publik të zgjatë 30 ditë, përkatësisht nga data 31 tetor 2019 deri më 29 nëntor 2019, ndërsa debati publik me qytetarë të mbahet më 15 nëntor 2019 duke filluar në ora 11:00 në sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës.

3. Propozim Rregullorja për Mbrojtjen e Mjedisit në Komunën e Podujevës

z.Faik Muçiqi, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit - DSHPMSSH, theksoi, meqe dy rregulloret kanë kaluar procedurat paraprake, janë mbajt diskutimet/debatet publike dhe nuk ka pas ndonjë ndryshim plotësim të theksuar nga dokumentet fillestare e që besoj se më gjerësisht drejtori i Drejtorisë përkatëse do të sqarojmë gjerësisht në mbledhjen e Kuvendit, do të ishte mirë që të rekomandohet për mbledhjen e Kuvendit kjo pikë e rendit të ditës, sigurisht duke lënë mundësinë që nëse ndokush ka diçka për propozuar, plotësuar apo ndryshuar më mirë do të ishte ta sqarojmë këtu.

Njëzëri i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

4. Propozim Rregullorja për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Podujevës

z.Faik Muçiqi, drejtor i DSHPMSH, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj propozim rregulloreje, ndër të tjera theksoi, gjithashtu ky dokument ka fillimisht në Kuvend me draftin fillestar dhe njëkohësisht i dhënë miratimi për diskutim/debat publik, është zbatuar diskutimi publik dhe është mbajti debati publik mu në këtë sallë. Interesimi më i madh ka qenë i kompanive përkatëse, e që është e drejtë e tyre, dua të them se më shumë janë kyçur grupet e interesit. Ka pas disa plotësi ndryshime që janë bërë gjatë kësaj periudhe, mirëpo tani së fundmi janë vërejtur edhe disa gabime teknike të cilat nuk janë korrigjuar, tani vërejtja këtu tek faqe 7 neni 11 pikat 4 dhe 5 ku duhet të hiqet dhe është mirë të evidentohen sepse përsëritën pa nevojë dy herë, ngase e njëjta çështje rregullohet në nenin 12 të dokumentit, pastaj tek neni 8 fjalia në fund “të vendoset tek përgjegjësitë” duhet të hiqet sepse është e tepërt.

Besoj se keni vërejtur edhe në konstatime se kjo propozim rregullore do të hyj në fuqi në qershor 2020 ngase për arsye se me këtë inkasimin e merre Komuna prandaj duhet paraprakisht të përgatitemi e që bashkërisht me ndihmën e organizatës GIZ-in besoj se do të përgatitemi deri në qershor, qoftë me kuadër qoftë me sistem dhe çështje tjera të nevojshme procedurale ku do të hapet kod i ri buxhetor nga Ministria e Financave për inkasim si burim i të hyrave. Pra tarifa për mbeturina do të jetë komunale dhe obligative sikurse që është tatimi në pronë. E kemi parasysh se çështja e inkasimit do të jetë paksa e vështirë si mënyrë në fillim, ngase Komuna merre përsipër inkasimin e tarifës kurse kompanitë e kryejnë punën e vet e që duhet të ketë një buxhet shtesë pasi sigurisht inkasimi është më i vonshëm, dhe me 15 mijë ekonomi familjare të hyrat mujore nuk do të jenë të mëdha ndërsa kompanisë i intereson vetëm pagesa dhe jo gjërat tjera, mirëpo si mënyrë konsiderojmë se kjo është e vetmja mënyrë për të përmirësuar menaxhimin e mbeturinave e që nga muaji qershor 2020 planifikojmë të fillojmë me këtë ndryshim me qëllim që të kemi një ambient më të pastër, dhe po ashtu të fillojmë edhe me penalizime qoftë ndaj kompanisë qoftë ndaj qytetarëve, ngase duhet të kryejnë obligimet si dhe të sillen karshi obligimeve ndaj Komunës.

z.Avni Fetahu, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e LDK-së e përkrahim dhe i rekomandojmë këtë propozim rregullore për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen e Kuvendit, mirëpo kamë një pyetje, duke marrë parasysh nga përvoja tek objektet shkollore dhe atyre shëndetësore, pasi që punëtorët teknik të tyre dinë të tregojnë mirë sa kanë hapësirë për mirëmbajtje, për pastrim të oborreve, e që shumë herë kemi parë që oborret janë të papastërta, deshta të di me këtë rregullore a parashihet që kompania të intervenoj në oborre të shkollave ti pastroj ato ngase drejtorët e shkollave dëshirojnë të kenë një kompani që kujdeset për ta.

z.Faik Muçiqi, drejtor i DSHPMSH, sqarim parafolësit, oborri i shkollës, oborri i Komunës dhe të tjera janë hapësira publike dhe nuk kanë të bëjnë me menaxhim të mbeturinave, kompanitë vetëm bartin mbeturinat e që mund ti bartin edhe nga këto hapësira, por jo edhe mirëmbajtjen e oborreve të tyre, ato do të duhej të jenë kontrata të veçanta, siç janë tek qyteti etj, prandaj grumbullimi i mbeturinave nga institucionet po do të bëhet por jo edhe brenda shkollës të mbledhin dhe të pastrojnë.

z.Avni Fetahu, theksoi, sipas asaj që drejtori parafolës e ceku, atëherë qenka i nevojshëm edhe një harmonizim më i mirë ndërmjet Drejtorisë së Arsimit dhe Drejtorisë në fjalë që ti adresoj kërkesat në mënyrë që mos të mbes grumbulli i mbeturinave brenda shkollave.

z.Faik Muçiqi, Drejtor i DSHPMSH, sqarim, kompania mund të shkoj dhe të marrë mbeturinat në kontejnerë të shkollave, por jo edhe me mbledh mbeturinat në oborret e shkollave në këtë rast, kjo duhet pasur parasysh edhe nga Drejtoria e Arsimit që ata punëtor që janë për mirëmbajtjen e shkollës të mbledhin edhe mbeturinat në oborre të shkollave.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, tek mirëmbajtja e oborreve të shkollës, përgjegjësin e ka drejtori i shkollës që duhet të angazhoj punëtorin teknik dhe të gjej format me ndonjë kërkesë për buxhet shtesë për punëtor shtesë ose ndonjë aksion me nxënë. Si mund të jetë vetëm një punëtor teknik dhe i njëjti ta mirëmbaj gjithë hapësirat përkundër punëve tjera, por drejtori duhet të gjej format, mendoj që edhe Komuna së paku dy herë në vit është mirë të ketë aksion për mbledhjen e mbeturinave në hapësira publike dhe që ju kishin bashkëngjitë të gjitha institucionet komunale dhe qytetarët edhe ne si këshilltar të Kuvendit që t'ju bashkohemi qoftë nëpër fshatra qoftë në lokalitete tjera të Komunës. Unë e mbështes që kjo çështje të kaloj në nivel komunal dhe që kompanitë të mbikëqyren sepse më mirë menaxhohet edhe kompania kur e paguan me atë inkasim, dua të them që ka më shumë efikasitet, nuk po them që është keq sepse në fshatin prej nga vi unë, janë shumë në rregull ata vinë një herë në javë nuk e kam asnjë vërejtje nuk mungon asnjëherë, tani për tani ajo kompani është me ekonomi familjare por shumë janë të rregullt dhe serioz deri tani dhe duhet t'i mbështetim të gjitha kompanitë e mbeturinave, por janë keq edhe hapësirat publike edhe varrezat për mirëmbajtje të mbeturinave.

Njëzëri i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim, me plotësim ndryshim, dhe atë; në nenin 8 paragrafi 5, pasuesi në fund "(Të vendoset të përgjegjësitë)" të hiqet, si dhe paragrafët 4 dhe 5 të nenit 11 të fshihen në tërësi.

5. Propozim vendimi për rialokimin e buxhetit të Komunës për vitin 2019

z.Isuf Latifi, Drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave – DBF, theksoi, në bazë të analizave të bëra nga DBF, është ardh në përfundim se duhet ta shfrytëzojmë pjesën ligjore ku lejohet rialokim i mjeteve në programin deri 15% e që në fillim ka qenë situatë diskutabile a do të nënshkruaj Ministri i Financave në detyrë këto vendime apo jo, por që në fund është marrë vendimi për rialokim dhe është vendos që këtë vit të bëjmë një rialokim të tillë. Rialokimi është paraqitur në tri programe, në Drejtorinë e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Drejtorinë e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit dhe një pjesë shumë e vogël në Drejtorinë e Administratës. Gjatë kësaj mbledhje besoj që drejtorët e Drejtorive përkatëse do ti sqarojnë projektet e tyre, mirëpo do të doja të ndalem paksa te Drejtoria e Administratës ku së bashku me drejtorin kemi ardh në përfundim që ti rialokojmë 30 mijë euro nga kategoria mallra dhe shërbime në kategorin e komunalive duke marrë parasysht që në kategorinë mallra dhe shërbimeve ka qenë një planifikim prej 34 mijë euro për marrjen me qira të disa veturave por që nuk janë marrë, me përjashtim të një veture që është marrë për nevoja të Kryetarit të Komunës, pra është propozuar që ato mjete të shkojnë në kategorinë e komunalive në mënyrë që fundi i vitit mos të na zë me obligime ligjore në këtë kategori. Pastaj kemi një shumë prej 30,000.00€ si rezultat i investimeve në zgjerimin e ndriçimit publik, ndërsa buxheti për këtë kategori është pothuajse i njëjti. Kështu që këtu ka qenë një analizë e Drejtorisë së Administratës së bashku me ne që këto mjete të rialokohen në këtë kategori dhe dihet që kategoria e komunalive është një kategori shumë e ndjeshme sepse nëse nuk e paguajmë rrymën mbesim pa rrymë, nëse nuk e paguajmë ujin mbesim pa ujë etj të ngjashme, prandaj e kemi parë shumë të nevojshme që këtë rialokim ta bëjmë në këtë kategori.

Për kategorinë e infrastrukturës besoj që drejtori i DSHPMSh do të jep sqarimet e nevojshme, ndërsa tek kategoria e DPUMM një pjesë që është rialokuar e kemi ndje të nevojshme për shkak se procedurat e tenderimit për projektin e ndërtimit të sheshit-bulevardit të qytetit ka shumë vështirësi dhe i njëjti ende është në procedura ankimore e që si duket do të zgjatim prandaj Drejtoria në fjalë e ka analizuar dhe ka ardh në përfundim që një pjesë e atyre mjeteve nga ai projekt të barten në projekte të ndryshme që janë në përfundim e sipër të cilat e kanë mungesë të mjeteve ashtu siç janë përshkruar edhe në vendim.

z.Faik Muçiqi, Drejtor i DSHPMSH, theksoi, meqë Drejtori i DPUMM z.Hamdi Jaha nuk është prezent por që ka kërkuar nga unë të paraqesë kërkesën për ndryshim dhe plotësim të shumës së paraparë për rialokim, pra kemi ndryshim të mjeteve buxhetore dhe projekteve, ashtu siç po e shihni në materialin përkatës, sa i përket bulevardit sigurisht keni parë materialin, shumën dhe kodin buxhetor se sa dhe ku do të rialokohen, ndërsa për bartjen për rregullimin e shtratit të lumit Llap 20,000.00€, arsyeja e kësaj është se Komuna e ka një kontratë bashkë financuese me Ministrin e Administrimit dhe Pushtetit Lokal, besoj që arsyetimet tjera të nevojshme do ti jap vetë drejtori i DPUMM në seancën e Kuvendit. Sa i përket propozimeve për bartje buxhetore të DSHPMSH keni vërejtur se është një propozim i gjithmbarshëm i buxhetit në shumë 26,000.00€ apo rreth 1.2% e buxhetit total, e që destinohet në projekte që janë para përfundimit, pra nuk janë projekte të reja si dhe parandalohet deficit i buxhetor. Te rregullimi i hapësirave publike kemi të bëjmë me rregullimin e hapësirave të parku dhe të shkollave në Batllavë që ka qenë një staz për nxënës, mandej kemi zgjerimin e rrjetit të ujësjellësit në fshatrat Majac dhe Peran si dhe dy rrugë të qytetit që po rindërtohen e që kanë sistem të vjetër të ujësjellësit dhe që kanë probleme me furnizim andaj edhe janë duke u bërë punime, ndërsa pjesa tjetër e bartjes në shumë prej 14,509.00€ është për ndërtimin e ndriçimit publik. Prandaj me këtë rialokim në një mënyrë plotësojmë projekte dhe zvogëlojmë mundësin e suficitit por edhe borxhin publik.

Njëzëri i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim, me plotësim ndryshimin si vijon; në paragrafin 1.1. të nenit 1, shuma prej 382,115.00€ ndryshohet në 402,115.00€, përkatësisht rritet për 20,000.00€ të cilat rialokohen në projektin,

-Ndërtimi, riparimi dhe mirëmbajtja e Lumit Llap si dhe hapësirave publike përgjatë brigjeve të tij, kodi 43181, shuma.....20,000.00 €.

6. Raporti financiar për periudhën janar – shtator 2019

z.Isuf Latifi, Drejtor i DBF, paraqiti fjalën hyrëse, ndër të tjera theksoi, ky është raporti nëntëmuor pasi dihet se raportet tremujor dhe gjashtëmuor janë diskutuar në Kuvend, ky pra e ka pjesën shtesë përveç përmbledhjes së raporteve paraprake ku paraqiten shpenzimet dhe të hyrat për këtë nëntë muor.

Siç keni vërejtur në raport shpenzimet janë 13,113,386.00€, nëse e marrim si total është një shpenzim relativisht i mirë e nëse e krahasojmë me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar kemi afër 10% shpenzime më të larta. Ajo çfarë na shqetëson në këtë raport është se jemi në muajin e nëntë dhe kanë mbetur edhe dy muaj e gjysmë deri në përfundim të vitit e që shpenzimet prioritare ende nuk janë në shkallën e kënaqshme por shpresoj që në bazë të asaj që shihet në teren që përveç projektit të cekur i cili rialokohet, të gjitha ato projekte që kanë mungesë të mjeteve janë në përfundim e sipër dhe me rialokim të pjesës buxhetore atyre ju krijohet kjo mundësi që teknikisht të pranohen dhe të bëhen pagesat.

Si përfundim, unë personalisht nuk jam i kënaqur vetëm tek kategoria e kapitaleve, do të doja të jetë përqindja shumë më e madhe se që realisht paraqitet në këtë raport, mirëpo njëkohësisht edhe tek të hyrat e që mund të themi se është një realizim i mirë por që ka vend për përmirësime edhe pse tek kjo kategori kemi 10% më shumë se vitin e kaluar dhe kjo ndodh për shkak të rritjes së të hyrave të tatimit në pronë por sërish deri në fund të vitit do ta bëjmë maksimumin që edhe shpenzimet edhe të hyrat të jeni në një përqindje sa më të kënaqshme.

Njëzëri i rekomandohet Kuvendit për diskutim.

7. Informatë e përgjithshme e Drejtorisë së Administratës, për Sektorin e Gjendjes Civile - Podujevë për periudhën janar - shtator 2019

z.Gëzim Namani, Drejtor i Drejtorisë së Administratës, paraqiti fjalën hyrëse, ndër të tjera theksoi, ashtu siç është planifikuar në planin e punës së Kuvendit për vitin 2019 që në muajin tetor të jetë një informatë përkatëse nga Drejtoria e Administratës, ne e kemi sjell materialin dhe besoj se të gjithë e keni lexuar dhe analizuar informatën në fjalë, mirëpo nëse keni ndonjë pyetje specifike para se e njëjta ti rekomandohet Kuvendit, jam i gatshëm të përgjigjem qoftë këtu qoftë edhe në seancën e Kuvendit.

Njëzëri i rekomandohet Kuvendit për diskutim.

Mbledhja përfundoi në orën 14:35

**Procesverbalin e mbajti
Enis Sheholli**

**Nr.01-060/04-0084119/19
Podujevë,
28 tetor 2019**

**Kryesuesi i Komitetit
Fatmir Gashi**